



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 14.09.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Sami Boroci (AKR), Endrit Zabergja (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (i pavarur), Gëzim Mehmeti (AKR), Berna Saraçi (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkyetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkyetare, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Donika Qetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Lulëzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Osman Bllaca, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe të medieve.

Faqe 1 nga 6

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues.
Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2024.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Përparim Rama, në pikë të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth këtij propozim-vendimi, duke thënë se ne sot po e prezantojmë propozim-buxhetin për vitin 2024, ku dhe do t'i paraqesim disa projekte të drejtorive që kanë punuar palodhshëm për realizimin e projekteve të tyre. Hartimi i buxhetit paraqet një ndër punët më sfiduese për ne si administratë dhe një gjë e tillë është e kuptueshme, përfaktin se nevojat e qytetarëve të kryeqytetit dhe dëshirat për të bërë më shumë për Prishtinën, janë më të mëdha sesa mundësitet që i kemi në dispozicion. Buxheti për vitin 2024 do të jetë njëqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind mijë euro.

Valbona Makolli, drejtore, tha se Drejtoria e Financave e ka bërë hartimin e këtij propozim-buxheti, në bashkëpunim me kryetarin Rama dhe të gjitha drejtoritë komunale. Me pranimin e qarkoreve nga Ministria e Financave, ku edhe janë përcaktuar kufijtë buxhetor për buxhetet komunale, ne pas kësaj i kemi mbajtur disa dëgjime buxhetore me qytetarë të komunës dhe në disa lagje të qytetit, ku dhe janë propozuar disa projekte nga qytetarët, të cilat ne i kemi paraparë në këtë buxhet.

Donjeta Dragusha tha se të gjitha këto projekte të propozuara nga kryetari Rama, do ta bëjnë Prishtinën praktike dhe do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve tanë.

Ne si grup i asamblistëve të LDK-së, jemi të lumtur që çdo ditë e më tepër po jetësohen projektet dhe programi i premtuar nga LDK, në krye me kryetarin Rama, përkrahim kryeqytetit tonë, e këtë qytetarët po e shohin çdo ditë. Sigurisht që e përkrahim dhe urojmë që puna në të gjitha projektet të vijojë mbarë dhe mirë, pa u penguar nga askush.

Leutrim Retkoceri theksoi se ky është një buxhet i rëndësishëm, një buxhet ambicioz, i cili fokusohet në projekte të rëndësishme, qoftë në investime kapitale, në ndërtimin e një qyteti më të pastër, në një qytet me mobilitet.

Mendoj se me buxhetin e vitit 2024, do të realizohen të gjitha projektet e parapara, të cilat u prezantuan këtu në Kuvend, por ne presim që edhe nga drejtorët të kemi një sqarim, se këto projekte a do të janë të realizueshme gjatë vitit 2024, marrë parasysh praktikat e buxheteve nga vitet e mëparshme, që suficit shpesherë i ka kthyer në projekte të pambuluara.

Sami Boroci u shpreh se ky buxhet duket të jetë buxhet ambicioz, është buxheti më i madh i Komunës së Prishtinës, andaj mendoj se fillimi shi duhet të jetë i planifikuar mirë, sepse në të kaluarën kemi pasur keqplanifikim, ose realizim shumë të ulët të buxhetit.

Faqe2nga6

Andaj uroj që ky buxhet të mos mbetet peng i një kthimi mbrapa nga niveli qendror, sepse ky Kuvend tashmë e ka një shumicë të ligjshme edhe këto vendime duhet trajtuar si vendime të ligjshme.

Izet Sadiku, drejtor, tha se se si drejtori me qeverisjen Rama, në fushën e shëndetësisë kemi bërë disa ndryshime dhe ato ndryshime janë të prekshme, pra janë projekte kapitale të cilat kanë të bëjnë me shërbimet shëndetësore. Presim që së shpejti do të fillojë edhe ndërtimi i projektit të Spitalit të Qytetit. Në vazhdimin e këtyre projekteve do të kemi edhe rinoimin e disa QMF-ve etj.

Përparim Rama, kryetar, tha se sa i përket projektit për ndërtimin e Spitalit të Qytetit, kemi pasur disa takime shumë të frytshme dhe pozitive me Ministrinë e Shëndetësisë, andaj ne në këtë drejtim do të bashkëpunojmë me nivelin qendror. Gjithashtu si mundësi e kemi paraparë ndërtimin e spitalin terciar, diku në zonën e Gollakut, që ta kemi një spital të dinjitetshëm.

Besianë Musmurati, drejtore, tha se për projektin e dixhitalizimit të sistemit arsimor në shkolla, kemi ndarë një shumë të mjeteve prej 160 mijë euro. Po ashtu, kemi ndarë mjete edhe për projekte të tjera, por çka vlen të theksohet është projektit për ndërtimin e shkollës së re në lagjen "Kalabria", që ka qenë kërkesë e kamotshme e asaj lagjeje, që të kenë një shkollë filllore në atë pjesë.

Fatmir Dervishi tha se mjetet të cilat janë paraparë për rregullimin e oborreve dhe terreneve sportive, mendoj se janë pak, andaj kisha kërkuar që të rritet shuma e këtyre mjeteve, sepse kemi një situatë jo të mirë në disa shkolla, si në shkollën "Hasan Prishtina", "Ismail Qemali", "Zenel Hajdini", "Nazim Gafurri" dhe "Sami Frashëri", e që konsideroj se duhet urgjentisht të ndërhyhet në këto objekte shkollore.

Fikneta Bejta e përgëzoi drejtoren e Arsimit, e cila ka bërë një qasje krejt ndryshe për shkollat e komunës së Prishtinës. Është hera e parë që shkollat e Prishtinës kanë ndier dorën e pushtetit në renovim, në pastrim etj. Sa i përket digjitalizimit në shkolla, kërkoi të dijë se çka do të ndodhë me objektet shkollore në disa zona, sepse atje ne e dimë që nuk ka sigurim.

Endrit Zabërxha kërkoi të dijë se çka konkretisht po parashihet përfundimini me pajisje të artikujve të ndryshëm shkollorë. E dimë se një prej pretimeve kryesore të ekipit tuaj ka qenë instalimi i smartbordave nëpër shkolla. Ai pyeti se a po parashihet që në këtë buxhet të përfshihen shkollat e Prishtinës dhe ato të tjerat me këto pajisje, apo po flitet përfundimini me pajisje të teknologjisë, e nëse po, atëherë cilat janë ato?

Besianë Musmurati, drejtore, dha përgjigje në pyetjet e parashtruara nga parafolësit. **Adelina Sahiti**, drejtore, tha se Drejtoria e Mirëqenies Sociale vazhdon të jetë në fokus dhe në prioritet të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore përfundimini me gjithë banorët e kryeqytetit, me buxhetin të cilin e posedojmë, me fokus përfundimini e shërbimeve sociale, si përfundimini e kategorive të ndryshme sociale etj.

Përfundimisht, kemi tashmë me një linjë të caktuar, ku do të trajtojmë hulumtime të ndryshme sociale, të cilat pastaj do të na ofrojnë një pasqyrë të saktë dhe të plotë të

Faqe3nga6

gjendjes në territorin e kryeqytetit, se cilat janë nevojat, cilat janë kërkesat dhe cilat janë dëshirat e familjeve kosovare në aspektin social etj.

Granit Rugova, drejtor, tha se Drejtoria e Sportit për vitin 2024 ka planifikuar një buxhet më të madh, i cili kryesisht do të fokusitet te projektet: Arena Multifunksionale, vazhdimi i tribunës së stadiumit "2 Korriku", ndërtimi i fitneseve të reja, ndërtimi i terrenit sportiv në Hajvali, si dhe mirëmbajta e terreneve ekzistuese sportive, në Dardani, Ulpianë, Qendër, Bregun e Diellit, Mat, Gërmë, Koliq, Besi etj.

Sami Boroci kërroi nga drejtori i drejtorisë përkatës, që në të ardhmen mundësish të rritet buxheti për Drejtorinë e Sportit, me arsyetimin se Prishtina ka shumë klube dhe këto klube për të funksionuar si duhet kërkohet një buxhet më i madh.

Donjeta Dragusha kërroi të dijë se si është menduar realizimi i projektit, i cili do të lidhë lagjen "Arbëria" me Pallatin e Rinisë, dhe a ka ndonjë ide të këtij projekti.

Sami Salihu, kërroi të dijë se si do të veprohet në fazën e parë për ndërtimin e nënkalimit "Kalabri - Dardani".

Kumrije Shabani - Ramadani, kërroi të dijë se a është menduar për lokacionin e ri për objektin e Hortikulturës.

Sami Boroci, pyeti se në çfarë fazë do të planifikohet ndërtimi i Unazës së qytetit, segmenti lindje - jug – perëndim.

Leutrim Retkoceri kërroi të dijë se si është paramenduar ndarja zonale në gjashtë zona në territorin e kryeqytetit dhe si do të bëhet intervenimi infrastrukturor në këto zona.

Ajet Brajshori kërroi të dijë se në vitin e ardhshëm a do të kemi ndonjë investim në lagjen "Kodra e Trimave", si dhe a do të bëhet rregullimi i rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrat e komunës, pa bërë përjashtim të asnjë lokaliteti.

Muhamed Selmani kërroi nga kryetari Rama që të bëhet një zgjidhje, të shihet mundësia dhe mënyra e pastrimit të lumit Llap, pasi që me rastin e vërvoshimeve po shkaktohen dëme të konsiderueshme.

Në pyetjet dhe sugjerimet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, përgjigje dhanë Krenar Xhaferi, drejtor, Donjeta Sahatçiu, nënkyetare, dhe Përparim Rama, kryetar.

Plator Gërdovci, drejtor, bëri të ditur se njëra prej investimeve kryesore në bujqësi, si investim kapital, do të jetë ndërtimi i thertores së kryeqytetit, gjithashtu dhe ndërtimi i kopshteve urbane që i kemi në projekt, ku po tentojmë që përveç se në fshatra ta sjellim pak bujqësinë edhe brenda zonave urbane. Do të rrisim numrin e serave, po ashtu një pjesë të buxhetit do ta shfrytëzojmë për subvencionim të mekanizmit bujqësor etj.

Muhamed Selmani kërroi të dijë se a ka në Komunën e Prishtinës ndonjë deponi edhe frigorifer ku ruhen prodhimet bujqësore ose ku mund t'i deponojnë fermerët prodhimet bujqësore.

Kumrie Shabani - Ramadani kërroi të dijë se a do të ketë subvencione për bujqit, pasi që tash është sezoni i mbjelljeve vjeshtore.

Faqe4nga6

Fatmir Dervishi tha se shuma e mjeteve të parapara për projektin për ndërtimin e kopshteve bujqësore publike, konsideroj se është e vogël, andaj propozoj që kjo shumë e mjeteve të rritet.

Ajet Brajshori pyeti se a ka bërë ndonjë planifikim drejtoria se sa fermerë do t'i mbështetni me mekanizëm bujqësor dhe sa me serra.

Në pyetjet e parashtruar, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Plator Gërdovci, drejtor.

Lulëzim Fushtica, drejtor, tha se sa i përket projekteve në investime kapitale të kësaj drejtorie, ato janë të përqendruara, edhe pse kërkesat kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, ku njëra nga to ka të bëjë me pajisje me pompa zhytëse për Brigadën e Zjarrfikësve, duke pasur parasysh numrin e madh të intervenimeve, kryesisht intervenimet gjatë vërvshimeve, si dhe shumë projekte të tjera nga fusha e sigurisë. Elmira Nikçi kërkoi të dijë se për cilat ndërtesa është fjala kur thuhet "sigurimi fizik i ndërtesave".

Në pyetjen e parashtruar nga anëtarja e Kuvendit, përgjigje dha Lulëzim Fushtica, drejtor.

Mimoza Sylemani, drejtore, bëri të ditur se një pjesë e mjeteve nga buxheti i paraparë për këtë drejtori janë të dedikuara për "Arkitektin e qytetit" dhe për Platformen GJI. **Leutrim Retkoceri** kërkoi të dijë se a ka ndonjë listë të projekteve që është bër nga "Arkitekti i qytetit", duke e pasur parasysh se është viti i dytë që ndahet buxhet për "Arkitektin e qytetit".

Agron Canolli, tha se lagjet, si "Kolovicë e Vjetër", "Kolovicë e Re", "Vneshta" dhe lagjet përrreh janë duke u rritur, andaj do të ishte mirë që të parashihet ndërtimi i një bashkësie lokale, sepse besoj që do t'i ndihmonte jashtëzakonisht shumë banorët e këtyre zonave që t'i kryejnë shërbimet komunale në atë bashkësi lokale.

Ajet Brajshori, kërkoi të dijë se a është ndërmarrë diçka lidhur me ndonjë plan rregullues për lagjen "Kodra e Trimave".

Lidhur me pyetjet e parashtruara, përgjigje dhanë Mimoza Sylejmani, drejtore dhe Përparim Rama, kryetar.

Arta Balaj, drejtore, tha se investimet me buxhetin e paraparë të kësaj drejtorie po jetësohen për një mori projektesh kapitale, si ajo për Sallën Koncertale dhe Muzeun Bashkëkohor të Artit. Po ashtu, me këtë buxhet parashihet rivitalizimi dhe adoptimi i hapësirave të Tulltores për shfaqje të ndryshme. Gjithashtu, janë në program edhe mirëmbajtjet e objekteve vartëse të Drejtorisë dhe dekorimi i qytetit për festat e rëndësishme.

Faqe 5 nga 6

Endrit Zabërxha, fillimisht ceku se Prishtina në realitet dita-ditës po e rrit turizmin kahas vitit paraprak. Padyshim se kjo është një meritë edhe e qeverisjes Rama, por edhe e Drejtorisë së Kulturës. Është diskutuar në të kaluarën, se do të krijohet edhe një muze për gjenocidin. Ne e dimë që ka mungesë të objekteve të cilat në veçanti e dëshmojnë historinë e para njëzet vjetëve që e dëshmojnë gjenocidin nëpër të cilin ka kaluar populli ynë. Përveç artefakteve në Muzeun Kombëtar, nuk e di që kemi ndonjë pikë të veçantë, ku të gjithë ata turistë që po vijnë në Prishtinë, do të mund të shikonin se në çfarë ka kaluar Kosova, në çfarë ka kaluar populli ynë.

Arbnora Ajeti kërkoi të dijë se cila është arsyja, pse nuk është paraparë në buxhet Muzeu i Dhembjes, pasi që është një projekt shumë i rendësishëm për historinë tonë. Leutrim Retkoceri shprehu mendimin se një ndër problematikat më të mëdha në qytet, është çështja e grumbullimit të mbeturinave dhe çështja e transportit publik. Duke pasur parasysh këtë gjendje, mendoj se ky buxhet do të duhej të ishte më i madh për këta dy sektorë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, përgjigje dhanë Arta Balaj, drejtore, Përparim Rama, kryetar, dhe Valbona Makolli, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 26 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2024.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i mbledhjes
Pellumb Bajçinovci



Faqe bëngat